

Çfarë duhet të dini rreth kancerit të gjirit

NYC
HEALTH+
HOSPITALS



Jeto jetën tënde më të shëndetshme.

NYC
HEALTH+
HOSPITALS

Telefononi për të lënë një takim
1-844-NYC-4NYC (1-844-692-4692)



QËNDRONI TË INFORMUAR. NA NDIQNI.

nychealthandhospitals.org

Kanceri i gjirit është lloji i dytë më i zakonshëm i kancerit të gratë. Lajmi i mirë është që shumë gra mund t'i mbijetojnë kancerit të gjirit, në qoftë se ai zbulohet dhe trajtohet herët.



Çfarë është mamograma?

Mamograma është testi më i mirë për ta zbuluar herët kancerin e gjirit. Ajo është një seri fotografimesh të gjirit me rreze X, të cilat i lejojnë mjekët që t'i kërkojnë shenjat e hershme të kancerit të gjirit.

Mamogramat janë shumë të sigurta. Duhet rreth 20 minuta që të bëhet një mamogramë dhe ajo mund t'ju shpëtojë jetën. Testi mbulohet nga shumica e planeve të sigurimit mjekësor. NYC Health + Hospitals gjithashtu ju ofron mamograma me një pagesë të vogël ose pa asnjë pagesë.


Kur duhet të bëj një mamografi?

Gratë e moshës 40 deri në 74 vjeç duhet të bëjnë një mamografi çdo dy vjet.

Gratë nën moshën 40 vjeç ose mbi moshën 74 vjeç duhet të flasim me mjekun e tyre dhe të vendosin nëse do të bëjnë një mamografi.

Cilat janë disa shenja të kancerit të gjirit?


Disa gra kanë shenja dhe simptoma të kancerit të gjirit. Gra të tjera nuk kanë asnjë shenjë. Simptomat mund të përfshijnë:



+ Një kokërr e re në gji ose nën sqetull

+ Trashje ose ënjtje të një pjese të gjirit

+ Gropëza në lëkurën e gjirit



+ Skuqje ose lëkurë me petëza në zonën e thithës së gjirit ose përreth gjirit

+ një thithë që futet brenda ose që duket e zhytur


+ Dhimbje në gji

Flisni me mjekun tuaj nëse keni ndonjë prej këtyre simptomave.


Çfarë mund të bëj që t'i pakësoj mundësitë e mia për të pasur kancer të gjirit?

Duke bërë një jete të shëndetshme që në moshë të re mund t'ju ndihmojë t'i reduktoni shanset tuaja që të keni kancer të gjirit:

KUSHTOJINI VËMENDJE PESHËS SUAJ



PYETENI MJEKUN TUAJ RRETH RREZIOVEVE TË MARRJES SË TERAPISË SË ZËVENDËSIMIT TË HORMONEVE OSE TË TABLETAVE PËR TË MOS NGELUR SHTATZËNË



USHTROHUNI FIZIKISHT NË MËNYRË TË RREGULLT



LINI DUHANIN



KUFIZOJENI PËRDORIMIN E ALKOOLIT, JO MË SHUMË SE NJË GOTË NË DITË



KUFIZONI EKSPLOZIMIN NDAJ RREZATIMIT NGA TESTET MJEKËSORE ME RREZE SI RADIOGRAFITË ME RREZE X, SKANOGRAPHËT CT DHE SKANOGRAPHËT PET



USHQEJINI ME GJI FËMIJËT TUAJ



Mbani mend – kanceri i gjirit që zbulohet herët, mund të trajtohet. Flisni me ekipin tuaj mjekësor rreth shëndetit të gjinjve tuaj sot.